

MB CONSULTING SHPK

NUIS: L21428011V

**Pasqyrat financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

CONTENTS

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO.....	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
1. Informacion i përgjithshëm	7
2. Bazat e përgatitjes	7
3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël.....	8
4. Mjete monetare	12
5. Të drejta të arkëtueshme	12
6. Llogari të tjera të arkëtueshme.....	12
7. Shpenzime të shtyra dhe të ardhura të llogaritura	12
8. Aktive afatgjata materiale.....	13
9. Detyrime të pagueshme.....	13
10. Detyrime të tjera afatshkurtra.....	13
11. Detyrime tatimore.....	14
12. Huamarrjet	14
13. Kapitali i nënshkruar.....	14
14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit.....	14
15. Shpenzime të personelit.....	14
16. Shpenzime të tjera shfrytëzimi	15
17. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin.....	15
18. Angazhime dhe ngjarje të kushtëzuara.....	15
19. Ngjarje pas datës së raportimit	15

MB CONSULTING SHPK

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

<u>Aktivët</u>	<u>Shënime</u>	<u>31dhjetor2020</u>	<u>31dhjetor2019</u>
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	7,551,288	1,108,212
Të drejta të arkëtueshme	5	4,571,594	5,737,183
Llogari të tjera të arkëtueshme	6	777,826	1,545,920
Shpenzime të shtyra dhe të ardhura të llogaritura	7	601,228	695,502
Totali i aktiveve afatshkurtra		13,501,937	9,086,818
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	3,204,073	3,836,975
Totali i aktiveve afatgjata		3,204,073	3,836,975
Totali i aktiveve		16,706,010	12,923,793
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime të pagueshme	9	2,777,571	912,260
Detyrime të tjera afatshkurtra	10	495,684	6,502,486
Detyrime tatimore	11	867,938	579,528
Shpenzime të konstatuara		7,227	100,630
Totali i detyrimeve afatshkurtra		4,148,420	8,094,904
Detyrime afatgjata			
Huamarrje afatgjata	12	1,316,455	-
Totali i detyrimeve afatgjata		1,316,455	-
Totali i detyrimeve		5,464,875	8,094,904
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i nënshkruar	13	100,000	100,000
Fitimi/(humbja) e pashpërndarë		4,728,889	2
Fitimi/(humbja) e periudhës		6,412,247	4,728,887
Totali i kapitalit		11,241,135	4,828,889
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		16,706,010	12,923,793

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-15, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

MB CONSULTING SHPK**PASQYRA E PERFORMANCËS**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Shënime</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	28,099,423	24,613,692
Totali i të ardhurave		28,099,423	24,613,692
Shpenzime të personelit	15	(7,789,079)	(11,023,497)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(814,870)	(917,741)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	16	(11,573,050)	(6,541,231)
Totali i shpenzimeve		(20,176,999)	(18,482,468)
Fitimi/(humbja) nga aktiviteti i shfrytëzimit		7,922,423	6,131,224
Shpenzime financiare	17	(46,550)	(268,591)
Të ardhura/(shpenzime) financiare neto		(46,550)	(268,591)
Fitimi/(humbja) para tatimit		7,875,874	5,862,633
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	(1,463,627)	(1,133,746)
Fitimi/(humbja) e periudhës		6,412,247	4,728,887
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		6,412,247	4,728,887

Pasqyra e Performancës duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-15, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar në datën 23 Mars 2021 dhe janë nënshkruar nga:

Bledar Manaj
Administrator



BLEDAR MANAJ

MB CONSULTING SHPK**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Kapitali i nënshkruar</u>	<u>Fitimet e pashpërndara</u>	<u>Total Kapitali</u>
Gjendja më 1 janar 2019	100,000	32,125,178	32,225,178
Fitimi/(humbja) e periudhës	-	4,728,887	4,728,887
Dividendë të shpërndarë	-	<u>(32,125,176)</u>	<u>(32,125,176)</u>
Gjendja më 31 dhjetor 2019	<u>100,000</u>	<u>4,728,889</u>	<u>4,828,889</u>
Fitimi/(humbja) e periudhës	-	6,412,247	6,412,247
Dividendë të shpërndarë	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	<u>100,000</u>	<u>11,141,135</u>	<u>11,241,135</u>

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-15, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

MB CONSULTING SHPK**PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Shënime</u>	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit			
Fitimi/(humbja) e periudhës		6,412,247	4,728,887
Rregullime për shpenzimet jo-monetare:			
Shpenzime financiare jo-monetare		-	-
Shpenzime për tatimin mbi fitimin jo-monetar		845,828	(68,957)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		814,870	917,741
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punës		<u>8,072,945</u>	<u>5,577,671</u>
Ndryshim në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		2,027,958	10,000,565
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme dhe të tjera		819,628	(7,570,782)
Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit		<u>10,920,530</u>	<u>8,007,453</u>
Fluksi i mjeteve monetare nga investimit			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(181,969)	(602,660)
Mjete monetare neto nga aktiviteti i investimit		<u>(181,969)</u>	<u>(602,660)</u>
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit			
Hua të arkëtuara		1,530,639	-
Pagesa e huave		(214,184)	-
Dividendë të paguar		(5,611,940)	(20,737,588)
Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit		<u>(4,295,485)</u>	<u>(20,737,588)</u>
Rritje/(rënie) neto në mjetet monetare		<u>6,443,076</u>	<u>(13,332,795)</u>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	4	<u>1,108,212</u>	<u>14,441,007</u>
Mjetet monetare në fund të periudhës	4	<u><u>7,551,288</u></u>	<u><u>1,108,212</u></u>

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-15, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

MB CONSULTING SHPK ("Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 28/02/2012 me numër unik identifikimi (NUIS) L21428011V.

Selia e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në adresën Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Abdyl Frashëri, Ndërtesa 8, Hyrja 7, Ap.25, 1019, Tiranë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është shërbime kontabiliteti, këshillime fiskale, këshillime financiare, shërbime të tjera këshillimi, asistencë për themelimin dhe drejtimin e shoqërive, kryerjen e vlerësimeve, shërbime të trajnimit profesional, shërbime të ndryshme ndërmjetësimi për kryerjen e shërbimeve sipas marrëveshjeve të rena dakord me klientët. dhe çdo lloj veprimtarie të ligjshme.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) në Shqipëri.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike, përveç rasteve nëse specifikohet ndryshe.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë pasqyruar në Lekë e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Shifrat janë të rrumbullakosura në Lekë.

2.4 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare në përputhje me SKK, kërkon që menaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe supozimet bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë të ndryshëm në varësi të rrethanave. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi si dhe në çdo periudhë të ardhme që preket.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

2.5 Periudhat krahasuese

Të dhënat e periudhave të mëparshme mund të ri-klasifikohen për t'i bërë ato të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore.

2.6 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë. Drejtimi ka vlerësuar se nuk ka tregues financiare, operative, ose tregues të tjerë që mund të tregojnë vështirësi në aftësinë e Kompanisë për të përmbushur detyrimet e saj në të ardhmen e parashikueshme dhe veçanërisht në 12 muajt e ardhshëm.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël në vijim janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe nëse ka të tilla.

3.1 Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhe të huaj regjistrohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhe të huaj rivlerësohen në fund të çdo periudhe raportuese me kursin zyrtar të këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi i zërave monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Mjetet jo-monetare në monedhe të huaj regjistrohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit, ndërsa mjetet jo-monetare që maten me vlerë të drejtë rivlerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Fitimi ose humbja që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e performancës.

Kurset e aplikueshme të këmbimit të monedhave të huaja në Lekë janë si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
EURO	123.70	121.77

3.2 Instrumentet financiare

Instrumentet financiare jo-derivative përbehen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet me poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e performancës. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet me poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria behet pale në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe të tjera ekuivalente

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogarite rrjedhëse, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet deri në tre muaj.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Llogarite e arkëtueshme dhe llogarite e tjera të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe me pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jete në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogarite e arkëtueshme janë zhvlerësuar. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrjet

Huat e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur kostot e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Kapitali

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**3.2 Instrumentet financiare (vazhdim)****Te tjera**

Instrumente të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

3.3 Inventarët

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Pas njohjes fillestare inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël ndërmjet koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet sipas metodës së mesatares së ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të nevojshme për të kryer shitjen sipas metodës së koston mesatare të ponderuar.

3.4 Aktive afatgjata materiale**Njohja dhe matja**

Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vete shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës dreket dhe çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjate material kane jetëgjatësi të ndryshme, ato regjistrohen si zëra të ndryshëm të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurën nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet afatgjate material mbetur dhe njihen në të ardhura ose humbjet të tjera.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet. Toka dhe aktivitet në proces nuk amortizohen. Metodatat dhe normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe të mëparshme janë si me poshtë:

<u>Lloji</u>	<u>Metoda</u>	<u>Përqindja / vite</u>
Ndërtesa	Mbi vlerën e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mjete transporti	Mbi vlerën e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe të tjera	Mbi vlerën e mbetur	20%
Pajisje kompjuterike	Mbi vlerën e mbetur	25%

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Ndryshimet në jetën e dobishme të pritshme llogariten duke ndryshuar periudhën ose metodën e amortizimit, sipas rasti, dhe trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

Çregjistrimi

Një aktiv afatgjatë material çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten me përfitime ekonomike të mëtejshme nga përdorimi ose nxjerrja jashtë përdorimit. Fitime dhe humbjet në rasti të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**3.5 Aktivet afatgjata jomateriale****Njohja dhe matia**

Aktivitet afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria maten fillimisht me kosto. Kostoja e një aktivi afatgjatë jomaterial të blerë veçmas përfshin çmimin e tij të blerjes neto, duke përfshirë taksat e importit dhe taksat e parimbursueshme të blerjes dhe çdo kosto e drejtpërdrejtë për përgatitjen e aktivitet për përdorimin e tij të paramenduar. Kostoja e një aktivi afatgjatë jomaterial të blerë në një kombinim biznesi është vlera e tij e drejtë në datën e blerjes. Pas njohjes fillestare, aktivitet afatgjata jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot e mëpasshme

Kostot e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse nga përdorimi i tyre do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë dhe markat e krijuara brenda njësisë do të njihen në pasqyrën e performancës, kur ato ndodhin. Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e programeve kompjuterike njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet duke u bazuar mbi jetën e dobishme të aktivitet jomaterial duke filluar nga dita e parë e muajit që pason datën e vënies në përdorim. Metodatat dhe normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe të mëparshme janë si me poshtë:

<u>Lloji</u>	<u>Metoda</u>	<u>Përqindja / vite</u>
Programe kompjuterike	Mbi vlerën e mbetur	25%

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Ndryshimet në jetën e dobishme të pritshme llogariten duke ndryshuar periudhën ose metodën e amortizimit, sipas rastit, dhe trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

Çregjistrimi

Një aktiv afatgjatë jomaterial çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të mëtejshme nga përdorimi ose nxjerrja jashtë përdorimit. Fitimet ose humbjet që lindin nga nxjerrja jashtë përdorimit të një aktivi afatgjatë material, maten si diferencë në mes të ardhurave neto nga nxjerrja jashtë përdorimit, në qoftë se ka dhe vlerës kontabël neto të aktivitet dhe përfshihen në pasqyrën e performancës të periudhës.

3.6 Zhvlerësimi**Aktivitet financiare**

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi dhe të cilat mund të maten me besueshmëri. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të aktualizuara me normën efektive të interesit. Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale, ndërsa aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kthimi mund të lidhet objektivist me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

Aktivitet jo financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Nëse ka të dhëna të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorim është vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të parasë, që pritet të vijë nga përdorimi i një aktivi ose nga dalja e tij jashtë përdorimit në fund të jetës së tij të dobishme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, për shlyerje të menjëhershme etj. Të ardhurat dhe shpenzimet njihen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin. Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat njihen kur ndryshimi i pronësisë së bashku me rrezikun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi. Të ardhurat nga shërbimet njihen kur shërbimi është kryer, në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të larte lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.8 Qiratë

Qiratë të klasifikohen si qira financiare nëse kushtet e marrëveshjes transferojnë në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme të pronësisë tek qiramarrësi. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira të zakonshme. Pagesat e bëra për qiratë e zakonshme njihen dhe regjistrohen në pasqyrën e performancës në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

3.9 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan kontributet shoqërore dhe shëndetësore në emër të vet dhe të punonjësve të saj, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës në momentin që ndodhin.

3.10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për depozitat bankare dhe huat, si edhe fitimet nga diferencat e kursit të këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga luhatjet e kurseve të këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së performancës (nëse ka), dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e performancës me metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit në monedha të huaja paraqiten vlerën neto.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përbëhet nga tatimi aktual dhe nga tatimi i shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në pasqyrën e performancës përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt në kapital dhe edhe tatimi mbi fitimin përkatës njihet direkt në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, bazuar mbi normat tatimore që janë në fuqi në ose që janë në thelb të miratuara në datën e raportimit, si dhe çdo rregullim i njohur në periudhën raportuese për tatimin aktual të periudhave të mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerave kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së bilancit, duke aplikuar normat tatimore që pritet të aplikohen mbi diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar mbi normat tatimore që janë në fuqi në ose që janë në thelb të miratuara në datën e raportimit. Aktivët dhe detyrimet për tatime të shtyra kompensohen vetëm nëse ekziston e drejta ligjore për t'i kompensuar këto shuma dhe aktivët do të realizohen dhe detyrimet do të shlyhen në të njëjtën kohë. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet e mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur realizimi i të ardhurave të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktivët tatimorë të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa të mos jetë më e mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me to.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë, Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe gjithashtu mundësinë e rritjes së detyrimit tatimor dhe interesave. Ky vlerësim mbështetet në një sërë vlerësimesh dhe supozimesh që mund të përfshijnë gjykime lidhur me ngjarje të ardhshme. Informacione të reja mund të behën të disponueshme, që mund të shkaktojnë ndryshime në gjykimin e Shoqërisë lidhur me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; të tilla ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore të periudhës kur është bërë një përcaktim i tillë.

MB CONSULTING SHPK**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**3.12 Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si pasojë një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që do të jenë të nevojshme flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit.

3.13 Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare, përveç provizioneve për detyrimet e kushtëzuara të një njësie të blerë në një kombinim biznesi; ato paraqiten në shënimet shpjeguese përveç kur mundësia flukseve dalëse të burimeve ekonomike është e largët. Aktivët e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese nëse është e mundshme një hyrje e përfitimeve ekonomike.

4. Mjete monetare

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Vlera monetare në bankë	6,711,908	1,071,985
Vlera monetare në arkë	839,381	36,227
Totali	<u>7,551,288</u>	<u>1,108,212</u>

5. Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme përbehen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të arkëtueshme	4,571,594	5,737,183
Totali	<u>4,571,594</u>	<u>5,737,183</u>

6. Llogari të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme përbehen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paradhënie për punonjësit	494,800	-
Garanci të dhëna	232,847	242,334
Tatimi mbi vlerën e shtuar	50,180	-
Huadhënie afatshkurtër	-	973,640
Tatimi mbi fitimin	-	246,768
Të tjera	-	83,179
Totali	<u>777,826</u>	<u>1,545,920</u>

7. Shpenzime të shtyra dhe të ardhura të llogaritura

Shpenzimet e shtyra dhe të ardhurat e llogaritura përbehen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	19,583	115,387
Të ardhura të llogaritura	581,645	580,115
Totali	<u>601,228</u>	<u>695,502</u>

MB CONSULTING SHPK**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

8. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtime & përmirësime	Mjete transporti	Mobilje dhe te tjera	Pajisje informatike	Totali
Kosto					
Më 1 janar 2019	112,500	2,283,270	2,112,125	858,186	5,366,081
Shtesa	-	472,343	-	130,317	602,660
Pakësime					-
Më 31 dhjetor 2019	112,500	2,755,613	2,112,125	988,503	5,968,741
Shtesa	-	-	152,802	29,167	181,969
Pakësime					-
Më 31 dhjetor 2020	112,500	2,755,613	2,264,927	1,017,670	6,150,710
Amortizimi					
Më 1 janar 2019	20,869	-	799,608	393,548	1,214,026
Shpenzimi i vitit	4,582	505,196	288,500	119,463	917,741
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	25,451	505,196	1,088,109	513,011	2,131,766
Shpenzimi i vitit	4,352	450,083	267,456	92,978	814,870
Pakësime					-
Më 31 dhjetor 2020	29,803	955,279	1,355,565	605,989	2,946,636
Vlera e mbetur neto					
Më 31 dhjetor 2019	87,049	2,250,417	1,024,016	475,492	3,836,975
Më 31 dhjetor 2020	82,697	1,800,334	909,362	411,681	3,204,073

9. Detyrime të pagueshme

Detyrimet e pagueshme paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitorë për shërbime	2,777,571	912,260
Totali	2,777,571	912,260

10. Detyrime të tjera afatshkurtra

Detyrimet e pagueshme paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Garanci të marra	222,660	-
Parapagime të marra	220,762	220,762
Të tjera	52,262	352,752
Dividendë për t'u paguar	-	5,611,940
Detyrime ndaj personelit	-	317,031
Totali	495,684	6,502,486

MB CONSULTING SHPK

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

11. Detyrime tatimore

Detyrimet e pagueshme paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatimi mbi fitimin	599,060	-
Kontribute dhe TAP	238,385	329,296
Tatimi i mbajtur në burim	30,493	34,417
Tatimi mbi vlerën e shtuar	-	215,815
Totali	<u>867,938</u>	<u>579,528</u>

12. Huamarrjet

<u>Huamarrje afatgjata</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Hua nga institucione të kredisë	<u>1,316,455</u>	-
Totali	<u>1,316,455</u>	<u>-</u>

Gjatë periudhës Shoqëria ka marre një hua bankare me vlerën e principalit prej 1,530,639 Lek e cila pritet të jetë e pagueshme gjate dy viteve në vijim.

13. Kapitali i nënshkruar

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kuotat e kapitalit, të cilat janë njohur me vlerën nominale Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 100,000 Lekë dhe zotërohet nga ortaku i vetëm z. Bledar Manaj.

14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat përbëhen nga shërbimet e ofruara nga shoqëria gjatë rrjedhës së aktivitetit, si vijon:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Të ardhura nga shërbimet	<u>28,099,423</u>	<u>24,613,692</u>
Totali	<u>28,099,423</u>	<u>24,613,692</u>

15. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit përbehen si më poshtë:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Paga dhe shpërblime	6,803,167	9,662,104
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	<u>985,912</u>	<u>1,361,393</u>
Totali	<u>7,789,079</u>	<u>11,023,497</u>

Numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës ishte 8 (periudha paraardhëse: 9).

16. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit përbëhen si më poshtë:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Shpenzime qiraje	2,650,046	2,778,443
Shërbime konsulencë profesionale	5,444,080	-
Humbje nga mos-arkëtimet	1,505,596	1,281,555
Shërbime ligjore	161,761	559,084
Energji elektrike dhe ujë	274,367	328,539
Anëtarësime, trajnime dhe abonime	185,220	334,887
Transferime, udhëtime e dieta	69,644	111,285
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	142,313	178,109
Shpenzime bankare	142,394	76,098
Shpenzime të tjera	997,629	893,230
Totali	<u>11,573,050</u>	<u>6,541,231</u>

17. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2020 (2019: 15%).

Deklaratat tatimore të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara konsiderohen vetë-deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë regjistrimet dhe deklaratat e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin është si më poshtë:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Tatimi mbi fitimin:		
Fitimi (humbja) para tatimit	7,875,874	5,862,633
Shpenzime të panjohura	1,881,636	1,695,673
Fitimi i tatueshëm	<u>9,757,510</u>	<u>7,558,306</u>
Norma e tatimit aktual mbi fitimin	15%	15%
Tatimi mbi fitimin aktual	<u>1,463,627</u>	<u>1,133,746</u>

18. Angazhime dhe ngjarje të kushtëzuara

Gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime ligjore ose veprime të palëve të treta. Bazuar në mendimin e drejtimit të Shoqërisë, vendimi përfundimtar për këto çështje nuk do të ketë efekt në pozicionin financiar të Kompanisë ose nuk do të sjellë ndryshime në aktive.

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë çështje ligjore të ndërmarrë nga palë të treta kundër saj më 31 dhjetor 2020 që mund të sjellë humbje apo flukse të rëndësishme dalëse në të ardhmen.

19. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera të ndodhura pas datës së raportimit për të cilat kërkohet ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.

